



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.05.2014, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Ilir Meta – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të PD-së “Për ndryshimin e rendit të ditës dhe zhvillimi i një seance të jashtëzakonshme parlamentare”, në datën 15.05.2014.

Marrin pjesë:

Ilir Meta – Kryetar i Kuvendit

Ilirian Celibashi – ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin

Vangjel Dule – nënkryetar i Kuvendit

Edmond Spaho – nënkryetar i Kuvendit

Gramoz Ruçi – kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Edi Paloka – kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike

Dashamir Tahiri – nënkryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Drejtësi, Integrim dhe

Unitet

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Spartak Braho – kryetar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Petrit Vasili – kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim

Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit për Integrimin European

Genc Pollo – kryetar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Erion Braçe – kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financat

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Arta Dade – kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Mungojnë:

Shpëtim Idrizi – kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet

Fatmir Mediu – kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane

HAPET MBLEDHJA

Ilir Meta – Fillojmë mbledhjen.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka bërë kërkesën “Për ndryshimin e rendit të ditës dhe për zhvillimin e një seance të jashtëzakonshme parlamentare në datën 15.05.2014 për çështjen në fjalë”. Problem është ai që unë përmenda më parë. Unë e kisha menduar të bënim nesër një Konferencë Kryetarësh për këtë çështje, meqenëse dje pritej të vinte Erdogani, por ndodhi ajo që ndodhi. Sot ishte seanca. Seanca e jashtëzakonshme nuk ekziston as në Kushtetutë dhe as në Rregullore. Ekzistojnë mocionet të neni 98 dhe rruga tjetër është neni 31 “Ndryshimi i rendit të ditës”, të pika 2 e të cilit thuhet: “Për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendime me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm”. Këto janë dy rrugët sipas Shërbimit Juridik. Nuk e di si e mendoni ju, apo kolegët e tjerë këtë çështje?

Edi Paloka – Zoti Kryetar, unë e shpreha edhe në fjalën time, besoj, para seancës plenare. Kur flasim për seancë të jashtëzakonshme, nuk e kam thjesht fjalën për terma të Rregullores, por kam parasysh ngjarjen e jashtëzakonshme, të paktën për ne kështu është. Nuk e di si e konsideron maxhoranca, Asaj mund t’i duket normale, po neve na duket e jashtëzakonshme, qytetarëve u duket e jashtëzakonshme, medieve u duket e jashtëzakonshme dhe ndërkombëtarëve u duket e jashtëzakonshme. Kështu që unë po them edhe njëherë se, pavarësisht Rregullores dhe termave të saj, nuk mund të bëjmë sikur nuk ka ndodhur gjë, sepse ne, në fund të fundit, përfaqësojmë këtu ata qytetarë që janë jashtë dhe interesat e tyre. Në qoftë se ata kanë interes për një çështje, ne duhet ta diskutojmë në Parlament atë çështje dhe nuk duhet të bëjmë sikur nuk ka

ndodhur asgjë dhe nuk duhet të merremi me mushkonja, me zogj, etj. Kjo është e gjithë kërkesa jonë. Thelbi i asaj që ne kërkojmë është që t'i përshtatemi interesit të qytetarëve dhe të gjithë të tjerëve për këtë çështje. Nuk mund ta kalojmë sikur nuk ka ndodhur gjë, nuk mund ta kalojmë me një fjalim që mbajti Rama para dy ditësh apo me deklaratat e ministrit të Brendshëm njëherë kështu, e njëherë ashtu. Unë kërkoj, jo unë personalisht, por si kryetar i Grupit Parlamentar, që ta diskutojmë këtë çështje. Gjithkush duhet të paraqesë opinionin e tij për këtë çështje, sepse është një çështje që, duam apo nuk duam, implikon jo vetëm qeverinë, por implikon edhe këtë parlament. Nëse gjithsecili nga do të mbajë qëndrimin e tij, edhe ne do të jemi të qartë, edhe qytetarët do të jenë të qartë se çfarë qëndrimi mbajnë ndaj kësaj çështjeje, qoftë partitë politike, qoftë deputetët e veçantë brenda partive politike. Ta them hapur, ka deputetë edhe brenda Partisë Socialiste që mendojnë si ne, pavarësisht se nuk do ta thonë në parlament, pavarësisht se edhe mund të votojnë për këtë qeveri, por kjo është e vërteta dhe ne nuk mund t'i implikojmë të gjithë me qëndrimin tonë. As ju nuk e keni këtë të drejtë, as maxhoranca nuk e ka këtë të drejtë. Prandaj unë i kërkoja maxhorancës që të tregojë mirëkuptim dhe të pranojë të bëjë një diskutim të tillë sot në parlament, pra të mos bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë. Thashë mund të bëjnë si të duan, ne nuk i kemi votat për ta kaluar këtë rend dite. Jemi koshientë që pa vullnetin tuaj nuk mund të bëhet. Nuk e them as për presion e as për gjë tjetër, por mungesa e vullnetit për të bërë një gjë të tillë, do t'ju implikonte direkt. Jeni thjesht të implikuar.

Ilir Meta – Çfarë implikimi ka këtu s'e kuptoj?

Edi Paloka – Nuk e kuptoni se çfarë ka ndodhur?

Ilir Meta – Jo, në kuptimin e implikimit. Për çfarë implikimi bëhet fjalë?

Edi Paloka – Në qoftë se do t'i dilni në mbrojtje, atij zotërisë, që është Kryeministër dhe që është i implikuar tashmë për ne.

Ilir Meta – Çfarë ka bërë ai?

Edi Paloka – Për ne është i implikuar direkt me mënyrën sesi e ka fshehur gjithë këtë histori, si është përpjekur të krijojë alibi. I ka krijuar alibitë që në fillim, duke u tallur.

Ilir Meta – Atë të mushkonjave e kam thënë unë, jo ai.

Albana Vokshi – Jo, jo të dy bashkë.

Edi Paloka – Jo, u zutë me njëri-tjetrin kush ta thotë. Ai u mërziu pse ja zureti.

Ilir Meta – E thashë unë.

Edi Paloka – Ti je Kryetar Parlamenti.

Ilir Meta – Do ta them edhe atje unë, mos ki asnjë merak ti, sepse nëpër media kishte dalë që ishin marrë masa për të bërë dezinfektimin e mushkonjave dhe kjo gjë do bëhet. Ju doni debat, kjo është e drejta juaj. Ne po flasim sikur kemi kamerat këtu.

Edi Paloka – Jo, po flas tamam unë.

Ilir Meta – Le të flasim tamam. Më fal, është ana politike që po kapni ju. Ju keni mendimin tuaj, dikush tjetër ka mendimin e tij, por është edhe ana procedurale e Parlamentit. E thamë pra, seanca e jashtëzakonshme nuk ekziston, pavarësisht nga rëndësia e jashtëzakonshme që i jepni ju, apo që mund t'i japim edhe ne kësaj gjëje. Kemi dy rrugë: rruga e mocionit ose e dyta, që, siç e thatë ju, pa vullnetin e maxhorancës, kjo çështje nuk mund të hyjë në rendin e ditës, sepse duhen tre të pesta e votave. Pra, këto janë dy çështjet.

Tjetra, ju kërkoni, me të drejtë, që çdo palë të diskutojë, por unë kam një pyetje, në rast se ju mendoni se duhet diskutuar patjetër sot, sa kohë do diskutohet për këtë gjë, sepse është edhe rendi i ditës i programuar për sot?

Edi Paloka – Le të biem dakord për këtë të parën ne, pastaj atë e zgjidhim. Në qoftë se maxhoranca është dakord.

Ilir Meta – Unë *speaker* jam.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, kjo është një çështje e rëndësishme. Vëreni veten tuaj në vendin tonë!

Ilir Meta – Unë jam shumë i qartë. Unë do ta kisha kërkuar i pari, po të kishte ikur avioni. Tani që avioni është aty, Riformato është aty, Bajrami është aty, nuk kam asnjë shqetësim unë, por e ka prokuroria.

Edmond Spaho – Ne u pastruam në këtë çështje. Avioni ra aty. Ka të dhëna që faktet janë manipuluar. Është edhe në interesin tuaj që ky debat të bëhet.

Ilir Meta – Është gjë e pastër, o profesor. Këtë punë e ka Prokuroria tani. Po të kishte ikur avioni, vërtet që do të ishte diçka e rëndë.

Edmond Spaho – Iku prokuroria, por Kryeministri tha që opozita shikon mushkonjat dhe flet për avionë. Edhe mbasi u kap avioni...

Ilir Meta – Ministri i Mbrojtjes i bëri akuzat dhe vajti në prokurori e tha nuk ka prova.

Edmond Spaho – Mbasi u rrëzua avioni, Kryeministri tha prapë mushkonja, edhe sot mushkonja ka për të thënë. E dyta akuzoi opozitën: ju e keni nxitur, ju e keni manipuluar, ju e keni krijuar këtë histori. Atëherë çfarë duhet të bëjmë ne? Si qenka kjo punë kështu?

Ilir Meta – Si mendoni ju për këtë?

Edmond Spaho – Duhet bërë debat.

Ilir Meta – Sa kohë debat duhet bërë për këtë gjë, se kemi edhe rendin e ditës?

Edmond Spaho – Të biem dakord që do bëhet debat, pastaj se sa debat të bëhet nuk mund ta parashikojmë as unë e as ti.

Ilir Meta – Nuk po thotë njeri të mos bëhet debat. Ju shfrytëzoni Rregulloren dhe hajde të bëjmë debat. Të caktojmë ditën e mocionit.

Edmond Spaho – Nuk është çështje Rregulloreje dhe çështje...

Ilir Meta – Për ta futur në rendin e ditës, kjo është një çështje që duhet zgjidhur me grupet parlamentare, sepse është me vota atje. Ju doni që ta hedhim tani në votim edhe të themi që nuk u miratua, prandaj duhet t'i bisedoni këtë gjëra. Nëse do ju duhet kohë për t'i diskutuar...

Edi Paloka – Në votë do ta hedhim, se ne kemi kërkuar ndryshimi në rendin e ditës. Në qoftë se duan ta hedhin poshtë, nuk kemi asnjë kundërshtim, madje nuk e zgjasim as debatin këtu, se nuk ka nevojë. Në qoftë se nuk ka vullnet për t'u bërë, shkojmë aty, e hedhim në votim dhe vazhdojmë punën tonë.

Ilir Meta – Nuk është ky problemi.

Edi Paloka – Jo, ky është problemi. Se edhe për atë që thatë, "E kam thënë unë punën e mushkonjave..."

Ilir Meta – Po, unë e kam thënë.

Edi Paloka – Zotëri, ju jeni Kryetar Parlamenti.

Ilir Meta – Unë mbaj përgjegjësitë e mia.

Edi Paloka – Po nuk keni përgjegjësinë që ka Kryeministri.

Ilir Meta – Po, mirë dakord, ai ka përgjegjësi tjetër.

Edi Paloka – Ai nuk mund të bëjë gallatë, kur akuzohet nga një ish-ministër i Mbrojtjes dhe nga një ish-kryeministër.

Ilir Meta – Ish-ministri t'i çojë provat në prokurori.

Edi Paloka – Kjo teoria t'i çojë në prokurori...

Ilir Meta – Po ku t'i çojnë provat?

Edi Paloka – Atëherë, deputetët po ikin në shtëpi. Ne nuk po flasim më. Të merret prokuroria.

Ilir Meta – Keni punë të tjera plot.

Edi Paloka – Puna jonë e parë kjo është: t'u tregojmë qytetarëve të vërtetat, aq më tepër kur ato duan të fshihen nga qeveria.

Ilir Meta – Po nuk fshihen dot ato gjëra.

Edi Paloka – Që nuk fshihen dot, e morëm vesh, se ia solli, kushedi kush ia solli atij.

Ilir Meta – Riformato.

Edi Paloka – Po, po Riformato, por ia solli dikush nga qielli. Nga qielli erdhi tamam.

Edmond Spaho – Edhe emrin ku ia gjeti që...

Edi Paloka – Nga qielli erdhi tamam. Ia kemi sjellë ne...

Majlinda Bregu – Më duket sikur po e kthejmë në çështje gallate. Nëse ju mendoni se këtu nuk ka asnjë gjë për të diskutuar, nuk paska asnjë shqetësim, as ata që janë jashtë, as ne që jemi brenda.

Ilir Meta – Nuk thashë se nuk ka shqetësim.

Majlinda Bregu – Kjo gjë mund të shtyhet për nesër ose për pasnesër. Atëherë, hidheni në votim dhe të biem dakord.

Erion Braçe – Majlinda, pse përmend ata që janë jashtë? Ata që janë përjashta, kanë qenë tetë vjet aty dhe ti thoshe: “Çohu **Erzen** dhe dil përjashta”. Ç’na i kujtoni tani!

Majlinda Bregu – Për pjesën e akuzave të prokurorisë, mos bëni lojë me njëritjetrin, sepse kjo forcë politike ka ngritur akuza nga fillimi në fund, pa çuar asnjë në prokurori, duke u marrë me të gjithë ne kur ishim ministra. Një ditë nuk shkuat te dera e prokurorisë, prandaj luftën politike...

Erion Braçe – Kush, ne?

Majlinda Bregu – Ju, maxhoranca. Domethënë, opozita e djeshme me maxhorancën në qeverisje.

Erion Braçe – Ti ke merak që nuk të kemi çuar edhe ty?!

Majlinda Bregu – Po, edhe mund ta kishit bërë.

Pra, nuk çuar asnjë akuzë. Në rast se ju mendoni se kjo është një çështje që duhet të kalojmë në heshtje, atëherë hidheni në votim dhe vazhdojmë. Por nuk mund të shtyhet për nesër. Kjo mund të ishte bërë seancë ditën e shtunë. Do të kishte qenë në nderin e parlamentit, po ta kishit kërkuar një seancë ditën e shtunë ose të dielën.

Ilir Meta – Për çfarë?

Majlinda Bregu – Për atë që ndodhi.

Ilir Meta – Pse, çfarë ka ndodhur?

Majlinda Bregu – Nuk ka ndodhur asgjë?! Por ky është problemi, sepse duhet të shohim se çfarë ka ndodhur tani.

Ilir Meta – Ajo që ka ndodhur është gjëja më e mrekullueshme, janë arrestuar dy persona; po ashtu është një avion dhe një makinë atje. Kjo është një çështje që e ka prokuroria në dorë. Nëse do të kishte ikur, atëherë po.

Erion Braçe – Majlinda, na jep një provë për njëzet herët e tjera!

Ilir Meta – Mos flisni për mushkonjat, sepse njerëzit e filmuan dhe e fotografuan!

Edi Paloka – Njerëzit e kanë parë edhe herë të tjera, por janë kërcënuar.

Ilir Meta - Por nuk kanë sjellë filmime, as fotografi. Të gjithë shqiptarët kanë celular, apo jo?

Edi Paloka – Duhej bërë histori që të fillonin të filmonin.

Majlinda Bregu – Nuk është serioziteti i shtetit të celularët e qytetarëve të Divjakës, sepse po tallemi me njëri-tjetrin. Del ai të bëjë fotografi dhe ky qenka fakti. Po nuk pati fotografi, nuk paska fakte.

Erion Braçe – Majlinda, a e di se ku është prova? Është tek ajo letra e SHISH-it e vitit 2012, që e ka mbajtur ai ministri që citoni ju dhe nuk ka bërë asnjë veprim.

Majlinda Bregu – Unë nuk po citoj asnjë ministër. Cilin ministër po citoj?

Erion Braçe – Ai ministri që po hetohet si provë. Ky është muhabeti.

Majlinda Bregu – Ti e shikon që kjo është një ngjarje që ne duhet...

Ilir Meta – Të dëgjojmë pak zotin Shalsi.

Me qetësi, ju lutem!

Eduard Shalsi - E kuptoj acarimin tuaj.

Gjatë gjithë kohës na keni treguar Rregulloren, edhe kur kemi marrë fjalën në parlament, edhe kur na keni prerë fjalën, edhe kur keni bërë siç keni dashur. Të mos harrojmë që ka një ngjarje në të kaluarën, ka një “Gërdec” me gjithë ata të vrarë, ka një “21 janar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk e di se për çfarë ke ardhur ti, vëlla i dashur, as nuk e kam idenë.

Majlinda Bregu – Ne e kemi bërë një seancë për “Gërdecin”.

Erion Braçe – Ti ke bërë seancë për “Gërdecin”?! Kur e keni bërë, pas një muaji? Asnjë seancë nuk keni bërë. Nuk ke bërë as për “21 janarin”. Vrave katër veta aty në mes të bulevardit. Madje, dëshiron ta dish, ditën që duhej bërë seanca për “21 janarin”, ajo shoqja jote doli atje dhe bënte qitje me automatik. Dakord?! Madje, ajo shoqja jote, i publikoi edhe nëpër gazeta, ajo shoqja jote që është te rreshti yt. Kështu që lëre, mos hyr në këtë histori.

Ilir Meta – Edi, të lutem, me qetësi tani!

Ta dëgjojmë pak zotin Tahiri.

Edhe ti tani që merresh me “Gërdecin”, çfarë lidhje ka kjo?

Eduard Shalsi – Ku e mbështesin aspektin procedural? Ti bërë një kërkesë, ku ju the: “Doni debat, sa orë? Ne ju kërkojmë të dimë se ku mbështeteni?”

Ilir Meta - Dakord.

Eduard Shalsi – Me qetësi!

Dashamir Tahiri – Po filluam të merremi me çfarë ka ndodhur, do merremi deri nesër dhe nuk është produktive për asnjërin. Unë mendoj se kohë ka plot, 24 orë, dhe le të flasë kush të dojë. Qeveria për këtë punë është, të dëgjojë. Pas kësaj pjese, le të bëhet edhe ajo pjesa tjetër e seancës, dhe mbarojnë njerëzit. Deputetët për këtë punë e marrin rrogën. 24 orë mbaji këtu.

Ilir Meta – Për çfarë t’i mbajmë?

Dashamir Tahiri - Duan të flasin, le të flasin tani. Pas kësaj të bëjnë edhe rendin e ditës dhe të ikin në shtëpi.

Ilirian Celibashi - Kësaj i thonë të bëjmë muhabet.

Albana Vokshi - Ne e kemi listën e folësve. Bëjeni edhe ju listën e folësve, më pas të përcaktohet orari.

Arta Dade – Edhe ne do të përgatitemi.

Ilirian Celibashi - Këtu ka një kërkesë të thjeshtë: të respektohet procedura në lidhje me paraqitjen e kërkesës. Më duket se nuk ka kundërshtime për thelbin e çështjes për ta diskutuar dhe për ta debatuar, por le të paraqitet në formën dhe procedurën e kërkuar nga Rregullorja. Ky është minimumi i kësaj gjëje.

Edi Paloka - O Ilirian, unë mendoj se e paraqita qartë mendimin tim. Nuk po flas për Rregulloren. Edhe me Rregullore, edhe me vota ju...

Ilirian Celibashi - Edi, po e them sinjerisht, nuk po kërkon njeri të fshihet pas Rregullores. As juve nuk ju kushton asgjë ta formatoni të gjithë kërkesën në formë dhe në procedurë.

Edi Paloka - Nëse juve nuk ju duket një gjë kaq e rëndësishme sa për të prishur rendin e ditës...

Ilirian Celibashi - Këtë e thua gabim, se nuk e tha askush, as Kryetari, asnjë.

Edi Paloka - Unë këtë po them: për mua dhe për të gjithë kjo është një ngjarje aq e jashtëzakonshme, saqë meriton vëmendjen e parlamentit.

Ilirian Celibashi - Po, patjetër. Nuk ta tha njeri këtë.

Edi Paloka – Sot. Jo të mblidhemi njëherë nesër, më pas ta lëmë nga java tjetër. E meriton sot.

Ilirian Celibashi - As këtë nuk e tha askush. I gjithë diskutimi është që të paraqitet në formën dhe në procedurën e duhur.

Edi Paloka - Çfarë procedure? Po të hyjmë te procedura, ju përsëri votat i keni.

Ilirian Celibashi - Nëse doni vërtet sqarim nga qeveria, sepse besoj ai është institucioni që do të japë sqarim më së shumti, për të cilin ju keni interes për këtë çështje, duhet që...

Edi Paloka - Sikur t'i zbatoni ju rregullat që jeni në maxhorancë....

Ju jeni maxhorancë dhe nuk i zbatoni rregullat dhe na kërkon neve...

Ilirian Celibashi - Nëse doni që kjo çështje të sqarohet realisht, po ashtu të sqaroni të gjitha dilemat dhe pikëpyetjet tuaja, por edhe të dikujt tjetër, këtë mund ta bëjë personi kompetent ose struktura kompetente, ministri ose Kryeministri. Që të diskutojë secili prej deputetëve aty, i bie të bëjmë muhabet dhe diskutime. Secili do të japë një gjykim. A keni qëllim për debat?

Erion Braçe – Por çfarë debati, keni thënë pesë gjëra dhe për të pestat keni padi nëpër gjykata. Ju kanë paditur njerëzit.

Edi Paloka - Çdo deputet do të shprehet se çfarë qëndrimi mban për këtë çështje që ka ndodhur. Për këtë e kërkojmë debatin. E dimë që edhe Kryeministrin nuk do ta heqim. Ne duam që çdo deputet, kushdo, sepse me zor nuk do t'i detyrojmë, të prenoncohet në lidhje me këtë çështje.

Mendon si ne, mendon si Rama, mendon si vetja, si do që të mendojë, duam që të prenoncohen njerëzit dhe të shprehin mendimin e tyre. Kaq duam. Neve na duket ngjarje aq e rëndë, saqë e quajmë detyrim që deputetët, si njerëz të zgjedhur nga populli, të shprehin mendimin për këtë çështje. Kjo është ajo që po kërkojmë. Mbase edhe mund të mos jetë në Rregullore, mbase edhe ne nuk kemi të drejtë në aspektin e Rregullores.

Ilirjan Celibashi – Jo, i keni mjetet dhe mekanizmat.

Edi Paloka - Edhe me Rregullore, në qoftë se do, një kryetar grupi kërkon ndryshimin e rendit të ditës. Nëse ju keni vullnetin, e votoni dhe mbaron çështja.

Genc Pollo - Kalojmë në vendimmarrje dhe shikojmë.

Gramoz Ruçi - Do ta shpreh edhe unë mendimin tim.

Dëgjoni, zotërinj, parlamentarizmi është gjithçka, por mbi të gjitha është procedurë.

Genc Pollo - Është frymë.

Gramoz Ruçi - Është procedurë.

Do të vij edhe te fryma.

Pra, është procedurë, është Rregullore. Doni mocion me debat, bëni një kërkesë për mocion për debat që në fillim të javës, që nesër, që pasnesër. Doni të bëni mocion mosbesimi, bëjeni. Doni interpelancë, bëjeni. Çfarë të doni. Por nga të gjitha këto, nuk keni bërë asnjërën. Ata njerëzit që janë atje, kam bindjen se një pjesë e mirë e tyre po presin këtë ligjin e legalizimeve, presin t'u legalizohet shtëpia.

Edi Paloka - A t'i thërrasim?

Gramoz Ruçi - Të lutem!

Thirri.

Erion Braçe - Çfarë është ky, kërcënim?

O Palokë, na keni vrarë mu në mes të bulevardit dhe nuk ka mbetur më gjë për të na bërë!

Na ke varë mu në mes bulevardit dhe ti ke thënë: "Bravo, i lumtë dora atij që e vrau". Ti personalisht! Po, ik tani. O Palokë, ti hap unë ato letrat që kam, as ti nuk do ishe këtu këtë fare!

Edi Paloka – Po hapi, se do të them ndonjë fjalë tani. Do hapke ti letrat e mia! Le t'i hapësh ti dhe kushdo tjetër aty!

Gramoz Ruçi – Ti je kryetar i grupit tani, nuk je Edi Paloka, mos e personalizo problemet.

Edi Paloka – Këta të dy janë dhe Taulant Balla që mbrojnë kryetarin tuaj, sepse as ju vetë nuk e mbroni.

Gramoz Ruçi - Të vijmë te problemi. Çështjet e rendit të ditës, harrojini që ato nuk do t'i heqim, ato do të miratohen, do të diskutohen dhe do të miratohen sot. Janë dy reforma të rëndësishme, siç është ajo e legalizimeve edhe ajo e ligjit për arsimin e lartë. Ato do të kalojnë.

Atëherë, le të vijmë te fryma.

Genc Pollo - Mos na fol për arsimin e lartë, sepse nuk dua të të ndërpres.

Gramoz Ruçi – Do të vij tek ajo që ju e quani frymë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir Meta - Mos ndërhy, Genci.

Genc Pollo – Vetëm atë mos e quani reformë të rëndësishme.

Gramoz Ruçi – Po çfarë rëndësie ka, aq sa është, një nen.

Të vijmë te problem që keni juve, domethënë tek ai që ngrini dhe nuk po mbaj qëndrim nëse keni apo jo të drejtë, është apo nuk është shqetësim. Ja ku jeni. Doni të bëjmë dy orë debat para rendit: një orë ju, një orë ne, jemi të hapur ta bëjmë. Nuk doni

një orë, doni më shumë? Të mbarojmë këto që kemi në rendin e ditës dhe le të gdhihemi. Flisni sa të doni.

Albana Vokshi - Ne mendojmë që nuk duhet të procedojmë te çështjet e tjera, pa mbaruar këtë.

Gramoz Ruçi - Të lutem, keni tre variante. Ndiqni procedurat parlamentare. Jemi dakord nesër, pasnesër, të hënë, të martë, të mërkurë, kur të doni, me mocion mosbesimi, me mocion me debat, me interpelancë, si të doni. Le të flasim të gjithë deputetët. Doni sot, po: një orë ju, një orë ne, që tani. Ju jeni të përgatitur, ne jemi të papërgatitur fare, sepse nuk kemi ardhur për këtë punë fare. Kemi ardhur me një listë tjetër, që e kemi të depozituar. Doni që të flasim gjithë deputetët, jam plotësisht dakord, le të mbarojmë rendin e ditës, filloni derisa të mbarojnë të gjithë.

Ilir Meta - Dakord. Atëherë, më duket që kemi një propozim konkret nga zoti Ruçi, kështu që bëni konsultimet dhe të kontaktojmë përsëri sesi do të veprojmë. Për pesë minuta unë pres përgjigje.